



18 mars 2014, Prishtinë

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Zyrtarizohet bashkëpunimi për urbanizmin e Prishtinës

Sot me 18 mars 2014, Ian Cliff, Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës dhe Hajrulla Çeku, Drejtor i OJQ EC Ma Ndryshe, në konferencën e përbashkët për media zyrtarizuan bashkëpunimin mes palëve të lartpërmendura për projektin "Transparenca Online e komunës së Prishtinës".

Komponenta themelore e këtij projekti në komunën e Prishtinës është monitorimi i punës së Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Me këtë projekt synohet ngritja e nivelit të transparencës lokale në vendimmarrje përmes monitorimit të ekzekutivit të komunave dhe raportimin për praktikën e vendimmarrjes lokale. Pjesë e projektit do të jetë edhe asistenca teknike për vendosjen e rendit urbanistik në Prishtinë.

Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët e lartpërmendura zotohen:

- që të jenë partnerë strategjik në zbatimin e projektit, duke vepruar në transparencë të plotë dhe bashkëpunim të ngushtë me organizatën monitoruese.
- Komuna t'u ofrojë monitoruesve dhe stafit të organizatës qasje të papenguar në të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe qasje të papenguar në hapësirat e administratës komunale dhe në takimet e hapura të organeve të komunës.
- Stafi i organizatës do të realizojë standard të larta profesionale dhe monitoruese; do të sigurojë dialog të përhershëm me organet dhe zyrtarët komunalë për të gjitha çështjet e monitoruara, para se ato të publikohen në media, etj.

Përveç nënshkrimit të memorandumi të mirëkuptimit mes palëve të lartpërmendura, në këtë konferencë EC Ma Ndryshe prezantoi edhe produktet e para të punës në raport me Drejtorinë e Urbanizmit në komunën e Prishtinës, dhe të cilat janë gjetjet nga hulumtimi rreth planeve rregullative dhe zhvillimore të komunës së Prishtinës si dhe një raport preliminar mbi gjendjen e qendrës historike të qytetit të Prishtinës.

Ambasadori Cliff tha: "Ndërtimet ilegale paraqesin akt kriminal; ato e rrezikojnë mjedisin dhe sigurinë publike. Ballafaqimi me ndikimet e ndërtimeve ilegale paraqet kosto të lartë për buxhetet komunale. I bëj thirrje të gjithë qytetarëve që të jenë aktiv në raportimin e ndërtimeve ilegale në komunë; qeverisë qendrore dhe lokale të zbatojnë ligjet dhe shoqërisë civile të jenë mbikëqyrës aktiv dhe të sigurojnë që qeveria lokale dhe qendrore po i përmbahen ligjeve".

Kryetari i komunës Shpend Ahmeti theksoi se "transparenca është baza e qeverisjes së mirë. Qytetarët e informuar mirë mbi çështjet e rëndësishme bëhen aktiv në vendimmarrje, e kur



British Embassy
Pristina



qytetarët bëhen pjesëmarrës atëherë demokracia funksionon. Bashkëpunimin me shoqërinë civile në monitorim e shohim si diçka të natyrshme dhe të shëndetshme për çdo qeverisje. Bashkëpunimet e tilla me rezultate të prekshme do të shtojnë besimin e qytetarëve në institucione.”

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe të Mbrojtjes së Mjedisit të komunës së Prishtinës do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit www.online-transparency.org.



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.